



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 389 Prot  
13

Tiranë, më 13.05.2016

VENDIM

Nr. 21, datë 13.05.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 70, datë 18.03.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "*Spitali Rajonal Durrës*", i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk ka realizuar "*Njoftimin*" pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore të veçantë/specifike për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Në kontratën individuale të punës, kontrolluesi ka të parashikuar kushte dhe rregulla në lidhje me konfidencialitetin, por nuk ka të nënshkruar nga punëmarrësit "*Deklaratën e Konfidencialitetit*", sipas Vendimit nr.6 datë 05.08.2013 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*".
4. Konstatohet se, ambientet në të cilat ruhen dosjet/kartelat mjekësore të pacientëve, nuk janë të përshtatshme si në aspekt të vendndodhjes së tyre (për arsye se janë përshtatur bodrumet e godinës spitalore), po ashtu dhe në kushte teknike (për arsye se janë grumbulluar në një ambient nën nivelin e tokës). Sipër dosjeve kalojnë tubacionet e

shkarkimit të ujërave të zeza. Ka pasur përmbetje të herë pas herëshme nga shirat si dhe dëmtime të tubacioneve të shkarkimit të ujërave të zeza të godinës (vërtetuar në procesverbalet e mbajtura sa i përket përmbetjeve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të dokumentacionit kartela shëndetësore të pacientëve) dhe për këto arsye, kartelat mjekësore të para vitit 2008 janë dëmtuar plotësisht. Sa i përket aksesit fizik në këto bodrume konstatohet se dera e brendshme është me çelës, por dera e jashtme është e hapur dhe pa mbikëqyrur nga personeli i spitalit.

Për shkeljet e konstatuara, është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 26.04.2016, në të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime.

Në zbatim të neneve 93 e vijues të Ligjit nr. 8485.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", më datë 09.05.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet e mëposhtme:

- 1) Do të kishim dashur të merrnim disa udhëzime dhe në kuadër të mungesës së një trajnimit të stafit për shkeljet e gjetura kërkojmë kohë për përgatitjen e një rregulloreje të posaçme për të dhënat personale.
- 2) Kërkojmë instruksione lidhur me deklaratën e konfidencialitetit të punonjësve tanë.
- 3) Kërkojmë nga Zyra e Komisionerit të merren parasysh pretendimet tona për të na dhënë mundësinë dhe kohën për të vënë në zbatim legjislacionin në fuqi për shkeljet e gjetura.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika I, shkronjat "d" dhe "dh" të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë "*kundërvajtje administrative*" dhe sanksionohen me gjobë.

- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."

Kontrolluesi, Spitali Rajonal Durrës, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, pasi konsistojnë më moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave "*pacientë*."

## PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 22, 27, 28, 39/1 shkronjat "d", "dh" dhe 39/2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "Spitali Rajonal Durrës", me gjobë në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi "Spitali Rajonal Durrës", të marrë masa dhe krijojë kushte të përshtatshme teknike dhe organizative për ruajtjen e dokumentacionit fizik të kartelave shëndetësore të pacientëve në arshivën fizike.
5. Kontrolluesi, "Spitali Rajonal Durrës", të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 30 ditësh.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 13.05.2016

**Besnik DERYISHI**  
  
**KOMISIONERI**